



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**RREGULLORE**

**PËR**

**MBROJTJEN E SHËNDETIT NGA PRODUKTET E DUHANIT NË**

**KOMISIONIN E PAVARUR TË KUALIFIKIMIT (KPK)**

## **Neni 1**

### **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është garantimi i sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve dhe të personave të tjerë nga pasojat e dëmshme që sjell duhani për shëndetin e njeriut dhe mbrojtja e shëndetit publik nga përdorimi i produkteve të duhanit në mjediset e punës të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK).

## **Neni 2**

### **Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është marrja dhe zbatimi i masave parandaluese ndaj përfundimit të duhanit në mjediset e punës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK), në zbatim të neneve 15/a, 15/b të ligjit, nr. 9636, datë 06.11.2006 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", të ndryshuar.

## **Neni 3**

### **Baza ligjore**

Kjo rregullore mbështetet në:

1. Ligjin nr. 44/2015, datë 30.4.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
2. Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar;
3. Ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";
4. Ligjin nr. 9636, datë 06.11.2006 "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit", i ndryshuar;
5. Ligjin nr. 9131/2003, "Për rregullat e etikës në Administratën Publike", i ndryshuar;
6. Ligjin nr. 10 237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë";
7. Ligjin nr. 4/2014, "Për ratifikimin e konventës C187 të organizatës ndërkombëtare të punës (ILO) "Për kuadrin promociional të sigurisë dhe të shëndetit në punë - 2006";
8. Ligjin nr. 9474, datë 09.02.2006, "Për ratifikimin e konventës kuadër të organizatës botërore të shëndetësisë - Për kontrollin e duhanit".

## **Neni 4**

### **Përkufizime**

1. "Mjedis pune" konsiderohet çdo hapësirë e mbyllur, ku punonjësit ushtrojnë veprimtarinë dhe detyrat për të cilat janë punësuar, si dhe salla e mbledhjeve, salla e zhvillimit të seanceve, korridorët, shkallët, tualetet, magazina dhe çdo mjedis tjetër i mbyllur, që frekuentohet gjatë orarit të punës, në KPK.

2. "Pirje duhani" është ndezja, thithja dhe mbajtja në dorë e ndezur e çdo produkti duhani që digjet.
3. "Tavllë duhani" është një enë e vogël ku shkundet hiri i produktit të duhanit që po digjet dhe ku lihen bishtat e cigareve.
4. "Masat parandaluese të duhanpirjes" janë veprimtaritë sistematike, që synojnë të sigurojnë mbrojtjen e shëndetit të punëmarrësve dhe të personave të tjerë, që për arsye pune vijnë në institucion, duke zgatur jetën dhe përmirësuar cilësinë e saj.

#### **Neni 5**

#### **Përgjegjësia e punëdhënësit**

1. Punëdhënësi detyrohet të marrë masa dhe të miratojë rregulla për sigurinë dhe mbrojtjen e punëmarrësve, në të gjitha aspektet që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë nga përdorimi nga produktet e duhanit dhe ekspozimit të pavullnetshëm ndaj tymit.
2. Punëdhënësi në marrjen e masave për mbrojtjen e sigurisë e të shëndetit në punë, udhëhiqet nga parimi i trajtimit të barabartë.
3. Detyrimet e punëdhënësit për marrjen e masave të veçanta në punë të punëmarrësve, janë të domosdoshme për garantimin e sigurisë dhe shëndetit të tyre.

#### **Neni 6**

#### **Masat për ndalimin e pirjes së duhanit dhe personi përgjegjës**

1. Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe personi përgjegjës janë përgjegjës për vendosjen brenda mjediseve të institucionit të listës së trupave inspektuese për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit.
2. Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe personi përgjegjës, kanë për detyrë:
  - a. Vendosjen e shenjave të dukshme (të miratuara nga KNMSHPD-ja), që tregojnë se pirja e duhanit në këto mjedise është e ndaluar.
  - b. Heqjen e tavllave të duhanit në këto mjedise.
  - c. Mbikëqyrjen dhe respektimin e rregullave për ndalimin e pirjes së duhanit në mjediset e brendshme të institucionit.
  - d. Organizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuere në ditën botërore kundër duhanit (datë 31 Maj).

#### **Neni 7**

#### **E drejta e informimit**

Çdo punëmarrës duhet të informohet për pasojat shëndetësore, natyrën droguese dhe kërcënimin vdekjeprurës të shfaqur nga konsumimi i duhanit, si dhe për masat e marra për mbrojtjen e të gjithë personelit nga ekspozimi ndaj tymit të duhanit.

**Neni 8**  
**Institucionet përgjegjëse**

1. Institucionet përgjegjëse për kontrollin e zbatimit të këtij ligji, bëjnë verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
2. Institucionet përgjegjëse për kontrollin e zbatimit të ligjit nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar, janë:
  - a. Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit;
  - b. Inspektorati që mbulon fushën e punës;
  - c. Inspektorati i sigurisë ndaj zjarrit.

**Neni 9**  
**Shkelja e dispozitave**

1. Shkeljet e dispozitave të përcaktuara në ligjin nr. 9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:
  - a. 300.000 (treqintmijë) lekë personi i tatueshëm.
  - b. 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, personi përgjegjës në institucionet publike;
  - c. 5 000 lekë (pesë mijë) lekë, duhanpirësi;
2. Masa e gjobës parashikohet si dënim më vete dhe jepet nga trupat inspektuese. Ankimi ndaj vendimeve të trupave inspektuese, të përcaktuara në ligj, bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.
3. Pas përfundimit të procedurave të ankimit administrativ, bëhet ankim në Gjykatën Administrative, brenda afateve të parashikuara në dispozitat ligjore.

**Neni 10**  
**Rishikimi**

Kjo rregullore mund të rishikohet në çdo kohë, duke respektuar formën dhe procedurën e miratimit të akteve.

**Neni 11**  
**Hyrja në fuqi**

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të detyrueshme për njohje e zbatim nga i gjithë personeli i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK).
2. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Mbledhja e Komisionit të KPK.